

## SHENIMET SPJEGUESE

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar Potesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte te

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimeve qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

### **Informacion i përgjithshëm**

#### **Politikat kontabël**

Politikat Kontable janë në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit si dhe të Ligjit nr 9228 date 29,4,2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Pasqyrave financiare të shoqërisë sone janë të besueshme pasi në themel të tyre qëndrojnë parimet bazë dhe kërkesat e tjera të nenëve 9,10,11 dhe 12 të Ligjit nr 9228 date 29,4,2004 Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare si dhe paragrafet 34 deri në 69 të Standarteve Kombetare të Kontabilitetit"

Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të kontatuara). Mbi këtë bazë efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të tjera janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes dhe jo thjesht kur ndërhyr pagesa ose marrja e likuiditeteve apo e ekuivalenteve të likuiditeteve. Për këtë regjistrimet kontabël janë kryer në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime.

Efektet e veprimeve dhe të ngjarjeve që janë objekt i kontabilitetit janë regjistruar në libra kontabël, në rend kronologjik dhe në rend sistematik (metodologjik). Për regjistrimet metodologjike (në llogari) është zbatuar metoda e quajtur dyfishe. Regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese. Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare. Për përmbushjen e objektivave të sigurisë juridike, regjistrimet kontabël janë kryer duke respektuar parimet si vijojnë:

1. Mbështetja në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël); pakthyeshmëria (mosndryshueshmëria) e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre; ngrirja (ngurtësimi) i tërësisë së regjistrimeve (kronologjike dhe sistematike) në mbyllje të periudhave paraprakisht të caktuara brenda një ushtrimi vjetor. Dokumentet e shprehura në gjuhë dhe/ose në njësi monetare të huaja, të ardhura nga/ose të dërguara për njësitë ekonomike të huaja, që nuk kanë seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë, vlerësohen në gjuhën shqipe dhe vlerat shprehen në njësinë monetare shqiptare.
2. Mbatja e kontabilitetit është bazuar në regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike. Evidenca mbështetëse të kontabilitetit janë marrë dokumentat bazë, dokumentat plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar. Dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë. Njësi ekonomike, ka kontrolluar në menyr të vazhdueshme, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse.
3. Aktivet janë burime të kontrolluara nga njësi ekonomike jone në datë 31.12.2020, që kanë ardhur nga veprime të kryera apo ngjarje të ndodhura dhe nga të cilat njësi ekonomike pret përfitime ekonomike në

të ardhmen. Pra shoqëriatë ushtrone mbi to të drejtën e pronësisë (kontrollit juridik) Shoqëria zotëronon përfitimet ekonomike.(pra aktivet janë në gjendje të prodhojnë flukse parash)

**Shënime që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare**

**Shënime të tjera shpjeguese**

Hartuesi i Pasqyrave Financiare  
ROVENA ÇEPANI

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike  
VASIL MARGA

